

**GJYKATA KOMUNALE NË KLINË**  
**P.nr.36/2010**  
**25 Mars 2010**

**NË EMËR TË POPULLIT**

Gjykatësi i EULEX-it Francesco Florit, i ndihmuar nga procesmbajtësja Jacqueline Ryan

Në çështjen penale kundër

ABEDIN MUZLIJAJ, i biri i Muharrem Muzlijaj dhe Ajshe Pecaj, i lindur më 22.12.1976 në fshatin Banjë e Pejës, Komuna e Istogut, me vendbanim në të njëjtin vend, nr. i letërnjoftimit 1003239256, i martuar, hetues në Stacionin e Policisë në Pejë – nr. i kartelës së identifikimit 1048, Shqiptar-Kosovar

I akuzuar sipas propozim akuzës PPS.no.2/2010 të datës 28.01.2010, të ngritur në gjykatë më 01.02.2010, për veprat penale të

1. Shpërdorimi i pozitës zyrtare ose i autorizimit, sipas nenit 339 para. 2 në lidhje me para. 1 të KPK, dhe
2. Mashtrimi, sipas nenit 261 para. 1 i KPK

Pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor më 5 dhe 25 Mars 2010, në prani të

-Prokurorit Special Z. Reshat Millaku

-Akuzuarit Abedin Muzlijaj

-Avokatëve Orhan Basha dhe Ferid Gjickolli, avokatë mbrojtës për të akuzuarin

Pas shqyrtimit më 25 Mars 2010, shpall publikisht këtë

**AKTGJYKIM**

I pandehuri Abedin Muzlijaj shpallet i pafajshëm për kryerjen e veprës penale të mashtrimit, sipas nenit 261 para. 1 KPK;

I pandehuri shpallet fajtor për akuzën për Shpërdorim të pozitës zyrtare ose autorizimit, sipas nenit 339 para. 2 në lidhje me para. 1 të KPK sepse, në rolin e tij të policit hetues në Stacionin e Policisë në Pejë, i ngarkuar me hetimin e vrasjes së \_\_\_\_\_ në 2006, me qëllim të përfitimit të paligjigjshëm, ai ka shpërdoruar pozitën e tij zyrtare – gjatë Shkurtit ose Marsit 2008 ai ka shkuar në shtëpinë e \_\_\_\_\_, babait të ndjerit, në \_\_\_\_\_ dhe në prezencë të \_\_\_\_\_ ai ka kërkuar shumën prej 10.000 euro për të zbuluar kryesin e vrasjes së \_\_\_\_\_, me arsyetimin që ai duhet të paguante burimet e informacioneve. Ai e ka bërë këtë duke e ka ditur që mund ti paguaj informatorët nga buxheti i caktuar i Policisë së Kosovës. Në këtë mënyrë, ai pranoi pagesën prej 4.500,00 euro dhe 700 franga zvicerane nga \_\_\_\_\_ dhe \_\_\_\_\_, në tri raste të ndryshme.

Prandaj, në bazë të nenit 339.2 dhe 43.3 KPK i akuzuari

### **DËNOHET**

Për veprën e lartpërmendur dhe dënohet me një vit dhe gjashtë muaj burgim. Dënimi i shqiptuar është dënim me kusht, i kushtëzuar me kompensimin e dëmeve që i janë shkaktuar dhe , siç përcaktohet më poshtë, brenda pesëmbëdhjetë ditëve pasi që ky aktgjykim të merr formë të prerë.

Në bazë të nenit 391.1 n.5) dhe nenit 278 KPPK, koha e kaluar në paraburgim dhe në arrest shtëpiak do të llogaritet si pjesë e dënimit.

Arresti shtëpiak ndërpritet menjëherë. Do të lëshohet një aktvendim i posaçëm.

### **KËRKESA PASURORE JURIDIKE**

Në bazë të nenit 112.2 KPPK, Gjykata urdhëron Abedin Muzlijajn që ti paguaj dëmet që i janë shkaktuar dhe , të cilat janë përcaktuar të jenë 4.500,00 euro dhe 700 franga zvicerane.

### **SHPENZIMET E PROCEDURËS**

Në bazë të nenit 100 KPPK, i akuzuari urdhërohet të paguaj shpenzimet e procedurës, të përcaktuara në shumë prej 100,00 euro.

### **ARSYETIMI**

#### **Historia Procedurale**

Më 15.01.2010 Prokuroria Special ka paraqitur një aktvendim për fillimin e hetimeve kundër të pandehurit Abedin Muzlijaj (Polic hetues në Shtabin Rajonal të Policisë në Pejë), për veprat penale të *Shpërdorimit të pozitës zyrtare ose autorizimit* sipas nenit 339 para 3 në lidhje me para. 1 të KPK dhe *Marrja e Ryshfetit* sipas nenit 343 të KPK. Sipas aktvendimit, i pandehuri, në rolin e tij të policit përgjegjës për hetimet e një rasti të vrasjes, ka kërkuar 10.000,00 euro nga të afërmit e viktimës, me arsyetimin që atij i nevojiteshin të hollat për ti paguar informatorët me qëllim që të zbulojë emrin e autorit të krimit. Të hollat janë dhënë pjesërisht nga ana e të afërme në tri raste të ndryshme, së pari 3.000,00 euro, pastaj 700 franga zvicerane dhe në fund 1,500.00 euro.

I pandehuri është arrestuar më 19.01.2010 dhe më 20.01.2010 paraburgimin në kohëzgjatje prej një muaj është urdhëruar nga Gjykata e Qarkut në Pejë.

Duke vendosur mbi ankesën kundër aktvendimit mbi paraburgimin paneli i tre gjykatësve të Gjykatës së Qarkut në Pejë me aktvendimin e tyre KP.no.5/2010 të datës 22.01.2010, ka konsideruar që veprimet e të pandehurit përbëjnë veprën penale të *Shpërdorimit të pozitës zyrtare ose autoritetit*, sipas nenit 339 para. 2 në lidhje me para. 1 të KPK, pasi që

shuma që i është dhënë të pandehurit nuk arrin shumën prej 5,000.00 euro; prandaj paneli e ka ndryshuar aktvendimin dhe e ka kualifikuar veprën penale si vepër sipas nenit 339 para. 2 i KPK dhe ia ka referuar çështjen Gjykatës Komunale në Klinë si gjykatë me kompetenca lëndore dhe territoriale, pasi që veprimi penal është kryer në shtëpinë e palës së dëmtuar në fshatin \_\_\_\_\_, Komuna e Klinës.

Më 01.02.2010 Prokurori Special e ka ngritur Propozim Akuzën kundër Abedin Muzlijajt për veprat penale të *Shpërdorimit të detyrës zyrtare ose autorizimit* sipas nenit 339 para. 2 në lidhje me nenin 1 të KPK dhe *Mashtrim* sipas nenit 261 para. 1 KPK.

Më 02.02.2010 paraburgimi është ndërprerë dhe zëvendësuar me arrest shtëpiak për një periudhë një mujore; më 25.02.2010 arresti shtëpiak është vazhduar për edhe një muaj.

### Kompetenca e Gjykatës

Në pajtim me nenin 21, paragrafi 1 nënparagrafi 1 i KPPK, Gjykatat Komunale kanë kompetencë që të gjykojnë, në shkallë të parë, veprat penale që dënohen me gjobë ose burgim deri në pesë vjet, po qe se për gjykimin e veprave të tilla penale nuk është kompetente gjykata e qarkut.

Në këtë çështje i pandehuri akuzohet për veprën penale të *Shpërdorimit të detyrës zyrtare ose të autorizimit*, sipas nenit 339 para. 2 në lidhje me para. 1 të KPK, që dënohet me burgim prej deri në tri vjet, dhe *Mashtrim* sipas nenit 261 para. 1 KPK, që dënohet me gjobë ose burgim prej deri në tri vjet. Dhe pasi që nuk ekziston asnjë dispozitë speciale që i jep autoritet Gjykatës së Qarkut që të gjykojë çështjen, Gjykata Komunale ka kompetencë lëndore që të gjykojë çështjen.

Veprat penale, sipas aktakuzës, janë kryer në fshatin \_\_\_\_\_, i cili është brenda territorit të Komunës së Klinës. Prandaj, në pajtim me Nenin 27 para. 1 të KPPK, Gjykata Komunale e Klinës ka kompetencë territoriale që të gjykojë këtë çështje.

Në pajtim me nenin 3 të Ligjit mbi Kompetencat, Përzgjedhjen e Lëndëve dhe Caktimin e Lëndëve të Gjykatësve dhe Prokurorëve të EULEX-it në Kosovë, Gjykatësit e EULEX-it të caktuar në procedurë penale do të kenë juridiksion dhe kompetencë për çdo lëndë të hetuar a të ndjekur penalisht nga Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës.

Prandaj, pasi që çështja e tanishme është hetuar dhe aktakuza është ngritur nga Prokurori Special i Kosovës, Kryetari i Trupit Gjykses është caktuar me vendim të Kryetares së Asamblesë së Gjykatësve të EULEX-it, në pajtim me nenin 22 para. 2 të KPPK. Duhet shtuar që *in limine litis* palët nuk kanë pasur asnjë kundërshtim ndaj caktimit të gjykatësit individual.

### Shqyrtimi Gjyqësor

Shqyrtimi gjyqësor është mbajtur më 5 dhe 25 Mars 2010 në praninë e Prokurorit Special Z. Reshat Millaku, të pandehurit Z. Abedin Muzlijaj, avokatëve të tij mbrojtës Z. Orhan

Basha dhe Z. Ferid Gjokolli. Palët e dëmtuara Z. dhe Z. kanë qenë prezent vetëm më 5 Mars 2010. Në pajtim me nenin 15 të KPPK, përkthyesit ndërkombëtarë kanë përkthyer procedurën gjyqësore dhe të gjitha dokumentet gjyqësore që kanë të bëjnë me gjykimin, nga Anglishtja në Shqip dhe anasjelltas, sipas nevojës.

### **Përmbledhja e Provave të Prezantuara**

Gjatë shqyrtimit gjyqësor palët e dëmtuara – dëshmitarët dhe kanë dëshmuar më 5 Mars 2010 dhe më 25 Mars 2010 janë lexuar dokumentet në vijim:

- Kopja e plotësimit të kallëzimit penal të Njesisë së Hetimeve Rajonale çështja numër 2006-DI-432 me datë 14.04.2008
- Transkripti i bisedës në mes të pandehurit dhe palës së dëmtuar
- CD-ja e monitorimit të bisedës
- Fotografitë e ndërtesës ku është kryer monitorimi i bisedës
- Fotokopja e fotografisë së një Kallashnikovi
- Një fletë që përmban emrin e dhe numrin e llogarisë bankare në Raiffeisen Bank
- Plani i amortizimit të kredisë të cilën e ka marrë familja e të pandehurit nga Raiffeisen Bank.

### **Përmbledhja e dëshmisë së dëshmitarëve**

-Gjatë marrjes në pyetje të 5 Marsit 2010 dëshmitari ka deklaruar që më 8 Tetor 2006 vëllai i tij është vrarë nga një gjuajtës i panjohur përderisa ishte duke vozitur së bashku me babanë e tyre. Policët e Njesisë Hetuese të Shtabit Rajonal në Pejë të Policisë së Kosovës kanë qenë përgjegjës për hetimet; në mesin e tyre ka qenë Z. Abedin Muzlijaj. Diku rreth Marsit 2008 i pandehuri ka shkuar në shtëpinë e tij në fshatin si pjesë e një rutine hetimore. Aty, ai ka kërkuar 10,000.00 euro nga pala e dëmtuar për ti paguar informatorët të cilët mund të zbulonin kush ishte vrasësi i vëllait të tij. Prezent aty ka qenë edhe babai i tij . Ai ia ka dhënë 3,000.00 euro Abedinit, pasi që nuk ka pasur më shumë të holla, dhe i ka premtuar që do të ia jep pjesën tjetër të parave më vonë. Me një rast tjetër ai ia ka dhënë 700 franga zvicerane si pjesë e të hollave që ia ka premtuar. Herën e treti ai ia ka dhënë 1.500 euro në restorantin Astro në fshatin Zllakuqan, ku Abedini ka qenë së bashku me një person tjetër me emrin . Përveç Abedin Muzlijajt, dëshmitari gjithashtu e ka kontaktuar Togerin , Udhëheqës i Hetimeve, dhe Major , Zëvendës Komandant i Shtabit Rajonal në Pejë. Dëshmitari ka shpjeguar që në takimin që e ka pasur me dy Eprorët e Lartë të Abedin Muzlijajt, ai iu ka treguar atyre që ai i ka dhënë të holla Abedinit me qëllim që të zbulohet kryesi i vrasjes së vëllait të tij. Në fund të kësaj marrje në pyetje ai ka shpjeguar që përderisa ka qenë në Zvicër, i pandehuri e ka thirrur atë në telefon duke kërkuar të holla pasi që ai e kishte një shok në burg, por dëshmitari i është përgjigjur atij që ai nuk ka të holla për të ia dërguar atij.

-Gjatë marrjes në pyetje të 5 Marsit 2010 dëshmitari ka deklaruar që më 8 Tetor 2006 i biri i tij është qëlluar me armë zjarri në veturën e tij. Ai ka qenë së bashku

me të. Atij i është thënë që përgjegjës për hetimet ishte Abedin Muzlijaj. Abedini e ka vizituar atë në shtëpinë e tij në fshatin \_\_\_\_\_ disa herë i shoqëruar nga një hetues tjetër me emrin \_\_\_\_\_. Në një rast i pandehuri e ka vizituar atë në shtëpinë e tij vetëm. Sa i kujtohet atij i pandehuri ka ardhur me një veturë të bardhë. Në dhomën e mysafirëve në shtëpinë e dëshmitarit ka qenë edhe \_\_\_\_\_, djali i \_\_\_\_\_. Dëshmitari ka deklaruar që Abedin Muzlijaj i ka kërkuar 10.000,00 euro për të zbardhur rastin e vrasjes. Ashtu që dëshmitari i ka thënë djalit të tij \_\_\_\_\_ që të ja jep të hollat të pandehurit dhe \_\_\_\_\_ aty ia ka dhënë 3,000.00 euro. Me një rast tjetër në dhomën e mysafirëve në shtëpinë e dëshmitarit ata ia kanë dhënë Abedinit 700 franga zvicerane. Me rastin e tretë, ata ia kanë dhënë të hollat Abedinit përderisa kanë qenë në restorantin Astro në fshatin Zllakuqan, ku \_\_\_\_\_ ia ka dhënë të akuzuarit 1,500.00 euro në një zarf. Dëshmitari nuk ka parë kur \_\_\_\_\_ ia ka dhënë të hollat, por më vonë \_\_\_\_\_ i ka treguar për këtë. Dëshmitari së bashku me djalin e tij \_\_\_\_\_ kanë shkuar që ti takojnë eprorët e Abedinit, Z. \_\_\_\_\_ dhe Z. \_\_\_\_\_, të cilëve ju kanë thënë që ata i kanë dhënë të holla Abedinit me qëllim që të zbardh rastin. Dëshmitari dhe djali i tij \_\_\_\_\_ janë takuar me Abedinin për herë të fundit në një kafene afër fshatit Ilixha.

### Dëshmia e të pandehurit Abedin Muzlijaj

Në seancën e 25 Marsit 2010 i pandehuri ka deklaruar që ai ka qenë duke punuar si Polic Hetues për Krime Serioze në Policinë e Kosovës, në Shtabin Rajonal në Pejë. Ai ka qenë i ngarkuar me hetimin e vrasjes së \_\_\_\_\_ në Dhjetor 2006 nga eprori i tij Toger \_\_\_\_\_, së bashku me Rreshter \_\_\_\_\_ si udhëheqës i ekipit të tyre, dhe Hetuesit \_\_\_\_\_ dhe \_\_\_\_\_. Ai ka shkuar shpesh në shtëpinë e \_\_\_\_\_ dhe \_\_\_\_\_ gjatë hetimeve, por ai gjithashtu ka shkuar atje për çështje private, sepse ai është bërë shok me ta gjatë vitit 2007. Ai e ka vizituar shtëpinë e \_\_\_\_\_ dhe \_\_\_\_\_ një herë në fillim të vitit 2008. Qëllimi i vizitës ka qenë një çështje private; ai ka kërkuar 10.000,00 euro si huazim nga \_\_\_\_\_ dhe \_\_\_\_\_ pasi që atij i nevojiteshin të hollat për të paguar këstet e kredisë të cilën e ka marrë familja e tij nga Raiffeisen Bank. Ai mohon të ketë kërkuar të holla me qëllim që të zbardh rastin e vrasjes së \_\_\_\_\_. Ai deklaron që familja e tij e kishte marrë nga kredi nga Raiffeisen Bank në shumë prej 120.000,00 euro për të blerë ca tokë në Pejë, me këst mujor prej rreth 2.500 deri në 2.600 euro. Biznesi familjar ka shkuar mirë deri në fillim të 2008. Në atë kohë ata nuk ishin në gjendje që të paguajnë këstet, ashtu që pasi që është konsultuar me babanë dhe vëllezërit e tij, ai ka vendosur që të kërkojë një huazim nga \_\_\_\_\_ dhe \_\_\_\_\_, pasi që ai u bë shumë i afërt me ta. Me atë rast në shtëpinë e tyre, \_\_\_\_\_ ia ka dhënë 3000 euro, pasi që nuk ka pasur më shumë. Me rastin e dytë ai i ka marrë 700 franga zvicerane në shtëpinë e \_\_\_\_\_ dhe \_\_\_\_\_. Me një rast tjetër, në restorantin Astro në fshatin Zllakuqan ai i ka marrë 1.500 euro, por ai thotë që të hollat janë dhënë si hua. Disa ditë para se që është arrestuar, saktësisht më 17 Janar 2010, ai ka qenë në restorantin Te Arrat duke festuar ditëlindjen e vëllait të tij kur e ka pranuar një thirrje nga \_\_\_\_\_ i cili e ka thirrur që të takohen dhe të pinë kafë. Prandaj, ai është larguar nga festa e ditëlindjes dhe ka shkuar atje menjëherë. Ai e konfirmon bisedën që e ka pasur me \_\_\_\_\_ dhe \_\_\_\_\_ atë ditë, por thotë që ai ka qenë pak i dehur, pasi që ka ardhur nga një festë e ditëlindjes dhe atij nuk i kujtohen të gjitha që janë diskutuar.

I pandehuri i ka prezantuar gjykatës një fletë në të cilën ishin të shkruar emri i \_\_\_\_\_ dhe disa numra, që pretendohet të jetë llogaria bankare e \_\_\_\_\_. I pandehuri ka thënë që atë fletë ia ka dhënë \_\_\_\_\_ në restorantin në Zllakuqan me qëllim që ai të ja kthen atij në Zvicër paratë e huazuara.

### **Fjalët Përfundimare**

#### **- Prokurori Special**

Në fjalën e tij përfundimtare Prokurori Special ka mbështetur propozim akuzën e tij sa i përket të gjitha akuzave. Sipas tij nga provat e administruara gjatë shqyrtimit gjyqësor është e pakontestueshme që i pandehuri ka kryer veprat penale të Shpërdorimit të Pozitës Zyrtare ose Autorizimit sipas nenit 339 para. 2 në lidhje me para. 1 të KPK dhe Mashtrimit sipas nenit 261 para. 1 i KPK. Në fakt nga dëshmia e dëshmitarëve dhe nga bisedat e monitoruara ishte shumë e qartë që i pandehuri, duke punuar si polic hetues, ka kërkuar 10.000,00 euro për të zbuluar kryesin e vrasjes së \_\_\_\_\_, djali i \_\_\_\_\_ dhe vëllai i \_\_\_\_\_, duke dhënë arsyetimin që ai duhet të paguaj informatorët. Prandaj i pandehuri ka përdorur pozitën e tij si polic hetues për të siguruar një përfitim të paligjshëm për vete.

Për më tepër, i pandehuri, edhe pasi që ai e ka paraqitur kallëzimin penal në Prokurorinë e Qarkut në Pejë, ende i ka pranuar të hollat të cilat atij ia kishin premtuar \_\_\_\_\_ dhe \_\_\_\_\_, pa i informuar ata që ai e kishte paraqitur kallëzimin penal. Prandaj, me këtë veprim i pandehuri e ka mashtruar palën e dëmtuar me qëllim për të siguruar një përfitim të paligjshëm për vete.

Në përfundim, Prokurori ka kërkuar nga Gjykata që të shpall të akuzuarin fajtor për veprat penale për të cilat është akuzuar dhe që ta dënojë atë në pajtim me ligjin me qëllim që dënimi të ketë ndikim në të akuzuarin, ashtu që ai të mos përsëritë veprat penale në të ardhmen dhe në përgjithësi, dhe që zyrtarët tjerë të mos kryejnë vepra të ngjashme.

#### **- Avokati mbrojtës Orhan Basha**

Avokati mbrojtës ka ngritur disa çështje në fjalën e tij përfundimtare. Si çështje të parë ai ka parashtruar që përfitimi i paligjshëm i dobisë pasurore mund të sigurohet në tri forma; së pari duke shpërdoruar pozitën zyrtare, së dyti duke tejkalluar autorizimet dhe së treti duke mos kryer detyrat zyrtare. Sa i përket kësaj, ka thënë avokati mbrojtës, prokurori i ka përzier këto forma, duke thënë që i pandehuri ka shpërdoruar pozitën e tij duke tejkalluar autorizimet e tij.

Si çështje të dytë, ai ka parashtruar që dy veprat penale kanë për qëllim mbrojtjen e dy vlerave të ndryshme të mbrojtura. Vepra penale e shpërdorimit të detyrës zyrtare ose autorizimit është kundër detyrës zyrtare përderisa vepra penale e mashtrimit është kundër pronës; prandaj, një veprim i vetëm nuk mund të shkelë dy vlera të ndryshme të mbrojtura (dhe dispozitat përkatëse të cilat kanë qëllim që ti mbrojnë).

Sa i përket kërkesës së të pandehurit për të holla, avokati mbrojtës parashtron që edhe pse nuk ka pasur kontratë me shkrim në mes të pandehurit dhe \_\_\_\_\_ dhe \_\_\_\_\_, ka qenë një kontratë verbale në mes tyre për huazimin dhe të hollat që i janë dhënë të pandehurit kanë qenë vetëm pjesë e huazimit që e ka kërkuar ai. Në fund avokati

mbrojtës ka kërkuar nga gjykata që të shpall të pandehurin të pafajshëm dhe ta lirojë atë nga të gjitha akuzat.

### **-Avokati mbrojtës Ferid Gjikolli**

Avokati mbrojtës Ferid Gjikolli në fjalën e tij përfundimtare ka deklaruar që në provat e administruara gjatë shqyrtimit gjyqësor, veçanërisht në dëshminë e [ ] dhe në njëërën anë dhe në dëshminë e të pandehurit, në anën tjetër, i vetmi dallim është që [ ] kanë deklaruar që të hollat janë dhënë me qëllim që të “zbulohen gjëra” përderisa i pandehuri që të hollat janë dhënë si huazim. Sipas avokatit mbrojtës të hollat janë kërkuar vetëm një herë, në fillim të 2008. Prandaj, hera e dytë dhe e tretë kur ata i kanë dhënë të holla të pandehurit, vetëm kanë ekzekutuar një premtim të dhënë më herët. Sipas mbrojtjes, në bazë të provave të administruara, versioni i Abedin Muzlijajt është i vërtetë përderisa arsyet për akuzat qëndrojnë në detyrimin e kryer nga mbikëqyrësit e të pandehurit në dëm të [ ]

Gjithashtu, në mbështetje të versionit të pandehurit është fleta me emrin dhe shënimet e llogarisë bankare të [ ] në Zvicër. Numri i llogarisë bankare pretendohet të i jetë dhënë të pandehurit me qëllim që ai të kthej të hollat të cilat ishin marrë si hua.

Përveç kësaj është edhe një dokument bankar i cili konfirmon që familja e të pandehurit kishte marrë një kredi në bankë, që mbështetë versionin që të hollat të cilat janë kërkuar nga [ ] dhe [ ] kanë qenë vetëm një huazim me qëllim që ai të paguaj borxhin familjar. Sa i përket veprës penale të mashtrimit, klienti i tij nuk e ka mashtruar askënd e as nuk ka gënjyer për të fituar dobi të paligjshme pasurore e as nuk ka fshehur ndonjë fakt nga pala e dëmtuar. Pra, nuk e ka mashtruar askënd.

Prandaj, ai i ka propozuar gjykatës që të lirojë të pandehurin nga të dy akuzat e propozim akuzës. Në rast se gjykata refuzon kërkesën e tij për lirim, ai ka kërkuar që gjykata të konsiderojë veprimet e të pandehurit duke iu referuar nenit 339 para. 1 i KPPK dhe të konsiderojë rrethanat lehtësuese në vendim, siç janë historia e tij e pastër, mospasja e dënimeve të mëparshme, sjellja e tij pozitive gjatë shqyrtimit gjyqësor, gjendja e tij ekonomike dhe sociale (jeton në një familje 20 anëtare me gruan dhe dy fëmijë).

### **- I pandehuri Abedin Muzlijaj**

I pandehuri në fjalën e tij përfundimtare deklaroi që atij i vjen keq për atë që ka ndodhur. Ai ka qenë person i besueshëm përderisa ka punuar në Polici dhe gjatë dhjetë viteve të punës nuk ka pasur asnjë ankesë ndaj tij. Ai gjithashtu ka shtuar që kopja e kallëzimit penal i cili i është dorëzuar Prokurorit Publik të Qarkut në Pejë i është dhënë edhe [ ] dhe [ ] më 16 Prill 2008 në prezencën e tij, nga ana e Major [ ], dhe që aty ka qenë prezent edhe [ ]. Pra, pala e dëmtuar ka qenë në dijeni që çështja i është dorëzuar Prokurorisë.

### **Gjetjet juridike dhe faktike**

Duke vlerësuar të gjitha provat e administruara, Gjykatësi konsideron që i pandehuri ka kryer veprën penale Shpërdorimi i pozitës zyrtare ose i autorizimit (neni 339 para. 2 në lidhje me para. 1 KPK).

Nga dëshmitë e palëve të dëmtuara dhe dhe ajo e të pandehurit, është vërtetuar në Tetor 2006 (djali dhe vëllai i palëve të dëmtuara) është vrarë me armë zjarri nga një gjuajtës i panjohur. Hetimet e këtij rasti janë nisur nga Policia Hetimore e Pejës, e cila është kompetente për territorin ku ka ndodhur krimi. I pandehuri, polici Abedin Muzlijaj, ka qenë përgjegjës për hetimet që nga Dhjetori 2006, së bashku me tre kolegë tjerë. Gjatë hetimeve, i pandehuri ka pasur disa kontakte me dhe

Në këtë kontekst, në Mars 2008 i pandehuri ka vizituar palët e dëmtuara dhe në shtëpinë e tyre me qëllim që të kërkoj nga ata një shumë të hollash.

Është e pakontestueshme që kërkesa është bërë dhe që të hollat (në shumën të ndryshme dhe me tre raste) janë dhënë.

Megjithatë, mënyrat e kërkimit janë përshkruar në mënyra kundërshtuese nga dhe , në njërin anë, dhe i pandehuri në anën tjetër.

Siç është ilustruar më parë, dy kanë deklaruar që Muzlijaj ka thënë që të hollat nevojiteshin për të zbardhur vrasjen e anëtarit të familjes së tyre, pasi që i pandehuri pretendonte që duhej ti paguante informatorët të cilit do ti tregonin se kush ishte vrasësi. Në anën tjetër, i pandehuri ka deklaruar që ai thjeshtë kërkoj një hua.

Duke marrë parasysh natyrën e fakteve (një kërkesë e thjeshtë verbale për të holla), nuk ekziston asnjë element direkt i konfirmimit të versionit të paraqitur nga dy palët e dëmtuara. Nuk ka asnjë shënim apo dokumentim të shkruar të marrëveshjes së arritur në mes të pandehurit dhe palëve të dëmtuara.

Deklaratat e dhe janë themeli i hetimeve. Ato janë konfirmuar në Gjykatë në mënyrë të kuptueshme nga ana e të dy dëshmitarëve dhe ato nuk ofrojnë asnjë element substancial për tu kontestuar. Në kontekstin e Kosovës, është dukur normale ose së paku e pranueshme për dëshmitarët që një informator të paguhet me të hollat e familjarëve të viktimës.

Për më tepër, babai, duke parë hezitimin e djalit të tij ndaj kërkesës së të pandehurit, e ka ftuar djalin e tij që ti merr të hollat që ishin në dispozicion aty menjëherë në shtëpi.

ka deklaruar që ai do të ishte i gatshëm të shiste tërë pronën e tij dhe të harxhonte gjithë pasurinë nëse do të ishte e nevojshme, për të zbuluar rrethanat e vdekjes së djalit të tij dhe në veçanti identitetin e autorit të krimit.

Gjatë marrjes në pyetje, i pandehuri dhe avokatët e tij mbrojtës as nuk kanë tentuar që të kundërshtojnë deklaratat e dëshmitarëve.

Një version shfajësues i fakteve është ofruar vetëm pas mbledhjes së të gjithë materialit provues kundër të pandehurit.

Gjatë marrjes në pyetje, vet i pandehuri në fund shpjegoi që ai, me të vërtetë, kishte kërkuar të holla nga dhe , por që e kishte bërë këtë me qëllim që të

merret me nevojat e familjes së tij, e cila kishte mbetur keq nga pagesat e një kredie nga një bankë vendore.

Versioni i Abedin Muzlijajt nuk është i besueshëm dhe nuk mbështetet me prova të mjaftueshme.

Më tej, tentimi që të diskualifikohen dëshmitarët duke deklaruar që ata janë detyruar nga mbikëqyrësit e të pandehurit që ta denoncojnë të pandehurin ishte jetëshkurtër.

Të konsiderojmë këto çështje:

1) versioni i të pandehurit nuk është i besueshëm. Abedin Muzlijaj ka pritur deri në rastin e fundit që të deklarojë që ai thjeshtë e ka kërkuar një hua nga \_\_\_\_\_ dhe \_\_\_\_\_, jo të holla për hetim. Ai kurrë nuk e ka përmendur këtë më parë. Kjo nuk është përmendur para gjykatësit hetues, kur i dyshuari ka pasur mundësinë e parë që të mbrohet dhe natyrisht do ta mbronte vetën nga një denoncim i tillë i turpshëm (kërkimi i të hollave për detyrë zyrtare). Çështja nuk është ngritur gjatë marrjes në pyetje të dëshmitarëve, kur do të ishte shumë thjeshtë dhe logjike që të përgënjeshtrohen deklaratat e tyre përpara gjykatës duke kujtuar kushtet e sakta të marrëveshjes, duke përmendur që \_\_\_\_\_ ia ka dhënë shënimet mbi llogarinë e tij bankare për pagesën e borxhit e kështu më tej. Të gjithë e kanë të qartë dhe kjo nuk mund ti ketë ikur një polici, i cili thotë (në seancën e fundit) që me kalimin e kohës ka fituar respektin dhe besimin e shumë gjykatësve dhe prokurorëve, që një kundërshtim i hershëm i një denoncimi shpifës do të ishte më i besueshëm. Pra, në përfundim, pse të pritet deri në fund që të tregohet tregimi dhe pse të tregohet copa e letrës me numrat e llogarive bankare të \_\_\_\_\_ vetëm në momentin e fundit?

Një teknikë e tillë mbrojtëse ka kuptim dhe në përgjithësi adoptohet në çështjet civile, ku argumentet më të mira rezervohen për propozimet e fundit, me qëllim që të parandalohet pala kundërshtare nga shtjellimi ose përgënjeshtrimi i tyre. Por në gjykim penal ajo është e panjohur dhe e len përshtypjen që është adoptuar për të parandaluar akuzuesit nga dhënia e përgjigjes. Në fakt, ka qenë e ditur dhe e qartë për të gjithë, nga fillimi i çështjes, që \_\_\_\_\_ dhe \_\_\_\_\_ do të vijnë në Gjykatë vetëm për të dëshmuar dhe që nuk do të jenë prezent për fazat tjera të gjykimit.

Duke ruajtur versionin mbrojtës për fund të gjykimit, i pandehuri dhe avokatët mbrojtës kanë shmangur mundësinë e ballafaqimit me \_\_\_\_\_ dhe \_\_\_\_\_ mbi çështjen kyçe të lëndës.

Kjo, natyrisht, nuk shkon në favor të besueshmërisë së versionit mbrojtës.

2) versioni i të pandehurit nuk mbështetet nga prova të mjaftueshme vërtetuese.

Përsëri, pse ka pritur i pandehuri derisa akuzuesit të largohen për të treguar këtë copë të letrës në të cilën, kinse, \_\_\_\_\_ kishte shkruaj detajet e llogarive të tij bankare? Ai ka thënë që detaji iu kujtuar në momentin e fundit. E besueshme? Në të vërtetë jo, nëse

konsiderojmë që e tërë çështja kundër të pandehurit sillej rreth natyrës dhe arsyeve për kërkimin e të hollave. Përsëri, si polic, si një hetues me eksperiencë, të gjitha këto aspekte duhet të ishin të pranishme në kuptimin e çështjes nga ana e të pandehurit.

Sa i përket dokumenteve që i ka dorëzuar i pandehuri gjatë seancës së fundit (deklaratat bankare dhe plani i pagimit të kredisë së kërkuar nga familja e të pandehurit), nuk është e kontestueshme që familja e të pandehurit në fillim të vitit 2008 ka pasur mungesë të likuiditetit dhe prandaj nuk ka qenë në gjendje që të paguaj kredinë që e ka marrë nga banka për të blerë një copë toke. Megjithatë, kjo nuk është provë relevante pasi që, në maksimum, mund të jep indikacion mbi arsyet e vërteta të abuzimit të kryer, por jo të përgënjeshtroj paraqitjen e fakteve nga ana e dëshmitarëve.

3) dhe nuk janë detyruar që ta denoncojnë të pandehurin: për detyrimin e supozuar të dhe nga ana e Toger dhe Major në dëm të pandehurit nuk ekziston fare asnjë provë. Në deklaratat që ia ka në dhënë hetuesve dhe më vonë gjatë marrjes së tyre në pyetje në Gjykatë, dëshmitarët vetëm kanë konfirmuar që, me gjasë të lodhur nga hetimi jopërfundimtar i çështjes së vrasjes së familjarit të tyre dhe nga premtimet e Abedin Muzlijajt, ata kanë kontaktuar dhe kanë takuar Toger , Udhëheqës i Hetimeve dhe Major , Zëvendës Komandant i Shtabit Rajonal në Pejës, të cilëve ata i kanë pranuar që ia kanë paguar një shumë të pandehurit. Vetëm atëherë, kuptohet qartë nga fjalët që i kanë përdorur dëshmitarët, ata janë ftuar nga mbikëqyrësit e Muzlijajt që të denoncojnë vartësin. Nëse ata janë “detyruar” ta denoncojnë atë pas një refuzimi fillestar, kjo nuk e mundur të vërtetohet.

Por nga konteksti është mjaft e qartë që as as nuk kanë pasur kurrfarë qëllimi që të fshehin atë që është perceptuar si sjellje e keqe e vartësit të tyre.

Në anën tjetër nuk është e qartë, nuk është thënë qartë dhe nuk është vërtetuar pse Togeri dhe Majori do të kishin detyruar dhe që ta denoncojmë rrejshëm Muzlijajn. Përderisa nga regjistrimi i bisedës në mes të Abedin Muzlijajt dhe duket që i pandehuri i fajësohte dy eprorët e tij për marrjen e rastit të vrasjes nga ai, kjo nuk mjafton për të vërtetuar që ata gjithashtu kishin për qëllim që ta denonconin atë rrejshëm.

Në fund, kjo ka qenë një justifikim, një pretendim që edhe u nxjerr në fund të gjykimit gjyqësor dhe i cili u favorizua vetëm nga interpretimi spekulativ dhe i pjesshëm i fjalëve të dëshmitarëve.

---

Prova të mëtjeshme dhe përfundimtare vërtetuese mbi faktet e pretenduara nga prokurori gjenden në bisedën në mes të dhe të pandehurit (në praninë dhe me intervenime episodike të ), biseda e regjistruar, në bazë të urdhrin për masa të fshehta të lëshuar më 15 Janar 2010.

Ligjshmëria e masës dhe rezultati i saj tashmë janë vlerësuar në vendimin e lëshuar gjatë seancës së parë të gjykimit.

Tani, duke iu kthyer përmbajtjes së bisedës, shfaqet që çështja e të hollave që ia ka dhënë Muzlijajt përmendet në dy paragrafe:

E para është si në vijim:

**: Çfarë të kam premtuar, unë dëshiroj ti lëvizi gjërat më tej, ti e di, ti kam dhënë pesë mijë, të tjerat kam planifikuar që ti jap por...**

Abedini: I kam humbur krahët...Ata më kanë premtuar...

: Por unë jam mbështetur në ty aq shumë, të them...

Abedini: Ti do të mbështetesh në mua përsëri , përgjithmonë, tento të më kuptosh....**çfarë mendon që unë të kam tradhtuar apo diçka e tillë....**

**: Por ti nuk mi ke treguar të gjithë personat, ky është problemi.**

Abedini: , **nuk mund të tregoj para se ta di 100%...**

Në paragrafin e dytë ne lexojmë:

Abedini: Betohe në fëmijët që i kam, e kam shtyrë vetën dhe jam futur mjaft thellë në telashe...**Kam pasur oferta nga njerëzit, ti e di atë, por unë ia kam dhënë fjalën këtij axhës , me askënd nuk jam marrë për shkak të së vrarit dhe të tjerëve, nëse ke edhe dyshimin më të vogël, Abedini do ti merr të hollat dhe do ti kthej një nga një...**

**: Jo, nuk është problem.**

Në asnjërin prej citimeve të hollave që janë dhënë nuk i bëhet referencë si të ishte një huazim, as fjalët as shprehjet nuk bëjnë të kuptojmë që të hollat janë huazuar dhe prandaj duhet të kthehen në një kohë. E kundërta është e vërtetë, kur palët i referohen të hollave, pranuesi i të hollave Muzlijaj deklaroi që është në disponueshmërinë e tij, qëllimin e tij që ti kthej ato në rast se nuk është në gjendje që të mbaj premtimin që e kishte dhënë më parë, si kusht për ti marrë të hollat.

Veçanërisht në paragrafin e dytë, çështja e premtimit të dhënë “këtij axhës ” është e qartë si edhe frika e shprehur nga i pandehuri që bashkëbiseduesit e tij ( ) e kanë humbur besimin e tyre në të (“nëse ke dyshimin më të vogël”). Duke shprehur qëllimin e tij që ti kthej të hollat nëse nuk është në gjendje të arrij atë që ia ka premtuar , vet Abedin Muzlijaj përgënjeshtroi mbrojtjen që e ka përdorur në gjykim. Nëse justifikimi për transferimin e shumës së të hollave ka qenë kryerja e një aktiviteti në favor të , kjo do të thotë që të hollat e dhëna nuk kanë qenë një huazim, pasi që justifikimi, në dy kontratat, është rrënjësisht ndryshe. Në rastin e një huazimi, justifikimi i transferimit të parave te pranuesi është obligimi i tij që të shpaguej huazimin, përgjithësisht (por jo domosdo) me shtesën e një kamate. Në çështjen që gjykohej, justifikimi i transferimit të parave nuk është kthimi i shumës së dhënë (kthimi i cili kurrë nuk kërkohet dhe që, kur ofrohet, refuzohet-“...nëse ke dyshimin më të vogël, **Abedini do ti merr të hollat dhe do ti kthej një nga një... : Jo, nuk është problem**”), por është ekzekutimi i një obligimi të Muzlijajt në favor të dy

Ky përfundim konfirmon versionin e dëshmitarëve, kur ata thonë që të hollat janë kërkuar dhe janë dhënë për një punë specifike të premtuar nga i pandehuri.

Cila ishte kjo punë? Çfarë është dashtë të bëj Muzlijaj për të mbajtur premtimin e tij ndaj ?

Edhe këto pyetje gjejnë përgjigje të lehtë në bisedën në mes të Muzlijajt dhe , veçanërisht në paragrafin e citimit të parë ku shpreh zhgënjimin e tij për faktin që, përkundër pagesës dhe premtimit, ai ende nuk e ka kuptuar identitetin dhe emrat e personave të përfshirë në vrasjen e vëllait të tij.

Për sqarim, paragrafi nuk lë shumë vend për interpretim:

○ : Por unë jam mbështetur në ty aq shumë, të them...

---

○ : **Por ti nuk mi ke treguar të gjithë personat, ky është problemi.**

Abedini: , **nuk mund të tregoj para e ditur 100%...**

---

Kërkesa e policit për të holla me qëllim që të zbardh vrasjen e një të afërmi të dy palëve të dy palëve të dëmtuara përbën shkelje penale të kryer nga i pandehuri.

Sipas dëshmitarëve, të cilët u gjet se janë të besueshëm dhe prandaj atyre i besohet edhe mbi këtë aspekt, të hollat janë kërkuar për të paguar informatorët me qëllim që të zbulohet kryesi i vrasjes së

Rikonstrukcioni i ngjarjeve pasqyrohet në kualifikimin ligjor të fakteve.

○ Justifikimi për kërkimin e të hollave rezulton në shpërdorim të detyrës së një polici pasi që krijon një shtrembërim, një trazim të funksionit të nënkuptuar të detyrës dhe në këtë mënyrë ndikon ose ndërhytë në kryerjen e detyrave zyrtare.

Nën këtë profil, është e rëndësishme të vërehet që shpërdorimi i pozitës së pushtetit dhe besimit të policit tashmë është krijuar kur është bërë kërkesa, ku paraqitet mundësia e përdorimit të parave e cila nuk korrespondon me ndonjë opsion të mundshëm të ligjshëm. Pas integritetit të krimit, bëhet qartë i parëndësishëm përdorimi pasues i të hollave. Nëse të hollat edhe përdoren më vonë nga ana e policit shpërdorues për nevojat personale (për shembull përdoret, siç është pretenduar, për pagesën e një borxhi familjar), krimi tashmë është kryer në kohën kur është bërë kërkesa. Kur mund të vërtetohet (siç është e qartë në këtë çështje) që qëllimi i kryesit është që të fitoj një fitim të paligjshëm të dobisë pasurore për vetën, shtrembërimi i funksionit publik përbën krimin e paraparë në nenin 339 KPK.

Të gjitha këto elemente janë të pranishme një sjelljen e Abedin Muzlijajt në shtëpinë e dhe në fillim të 2008. Kërkesa e tij për të holla, për nevojat e hetimeve (me qëllim që të paguaj informatorët) është qenësishëm shpërdorues pasi që

prezanton në kryerjen e një detyre zyrtare një element potencial të detyrimit dhe kushtëzimit, do të thotë një ndërhyrje të paligjshme të funksionit publik. Është e rëndësishme që viktimat e njëjta të krimit kanë qenë në dijeni për këtë trazim në momentin kur është bërë kërkesa. Kur është pyetur nga gjykatësi kryesues se a do të ishte e përfytyrueshme një kërkesë e ngjashme e bërë nga një polic Gjerman ose Zvicëran, për ekzekutimin e një funksioni zyrtar (hetimi i një krimi), ka pranuar që, qartazi, kjo nuk mund të ndodh në ato shtete.

Çështja e fundit mbi rikonstrukcionin e fakteve.

Nuk ekziston rreziku nga parashkrimi, siç kanë pretenduar avokatët mbrojtës të pandehurit: sjellja e paligjshme ka filluar me kërkesën për të holla por paligjshmëria e saj ka zgjatur deri në pagesën e fundit, e cila pakontestueshëm është bërë pas paraqitjes së raportit, në mes të Prillit 2008. Vazhdimësia e shkeljes nuk ka përfunduar deri në pagesën e fundit, prandaj çdo çështje e ngritur mbi parashkrimin bëhet e kotë.

---

Kualifikimi ligjor i veprës penale duhet të specifikohet më tej duke cekur që sjellja e të pandehurit bie nën nenin 339 para. 2 në lidhje me para. 1 KPK, pasi që shuma e paguar ka tejkaluar 2.500,00 euro por ka qenë më e vogël se 5.000,00 euro.

Avokatët mbrojtës kanë paraqitur vërejtjen që kualifikimi ligjor është dashtë të jetë nën dispozitën e përgjithshme të nenit 339 para. 1 KPK dhe jo në lidhje me dispozitën e paragrafit 2 të nenit të njëjtë, pasi që paragrafi 2 i referohet “dëmit” të shkaktuar nga kryesi, përderisa është dashtë ti bëhet referencë “dobisë pasurore” që ai e ka fituar nëpërmes kryerjes së krimit.

Mbi këtë çështje, mjafton të thuhet që neni 339 KPK parasheh shkallë të ndryshme të seriozitetit të shkeljes bazike të cilat të gjitha kanë një thelb të përbashkët (shpërdorimi, tejkalimi i kufijve ose moskryerja e një detyre, plus qëllimi për të fituar dobi pasurore ose për të shkaktuar dëm) por pastaj dallojnë për disa profile që i japin peshë të ndryshme kryerjes së krimit. Në bazë të asaj, legjislatori ka zgjedhur që ti referohet indikatorëve të ndryshëm të peshës së sjelljeve shpërdoruese të policit. Në çështjen që po ekzaminohet, besohet që kërkesa për të holla dhe pagesat përkatëse kanë shkaktuar një dëm korrespondent ndaj dhe , të cilët, në fakt, janë paraqitur përpara gjykatësit si palë të dëmtuara, duke kërkuar qartë që atyre të ju kthehen të hollat (mbi këtë aspekt, gjykatësi i ka bërë pyetje ).

---

Sa i përket veprës penale të Mashtrimit (neni 261 para. 1 KPK), Gjykatësi Kryesues së pari i referohet Aktvendimit të Panelit të përbërë nga tre gjykatës të Gjykatës së Qarkut në Pejë KP.nr.5/2010 të datës 22.01.2010 me të cilin, duke konsideruar principin e përgjithshëm të veçantisë, që vepra më e rëndë penale e absorbon atë më të lehtë, prandaj, në këtë rast, pasi që Mashtrimi bart një dënim më të lehtë se Shpërdorimi i

Pozitës Zyrtare, kjo vepra e fundit duhet të konsiderohet si e vetmja vepër penale e kryer nga i pandehuri.

Më tej, prokurori pretendon që i pandehuri, edhe pse e ka ditur që e ka paraqitur një kallëzim penal në Prokurorinë e Qarkut (sa i përket çështjes së vrasjes së \_\_\_\_\_), ai nuk ia ka treguar këtë \_\_\_\_\_ dhe \_\_\_\_\_ në kohën kur \_\_\_\_\_ ia ka dhënë të pandehurit 1,500.00.euro.

Gjykata është e mendimit që vepra penale është kryer ditën kur i pandehuri i ka kërkuar të hollat (10.000,00) dhe i ka pranuar 3.000,00 euro. Në muajt në vijim, të hollat të cilat janë dhënë me rastin e dytë dhe të tretë kanë qenë vetëm ekzekutim i premtimit të dhënë ditën kur i pandehuri i ka kërkuar të hollat. Prandaj, mashtrimi nuk mund të njihet dhe i pandehuri lirohet nga kjo akuzë.

### **Përcaktimi i dënimit**

Në këtë çështje i pandehuri është shpallur fajtor për veprën penale të Shpërdorimit të Pozitës Zyrtare ose Autorizimit, sipas nenit 339 para. 2 në lidhje me para. 1 KPK, që parasheh dënim me deri në tri vjet burgim.

Duke marrë parasysh rrethanat e rastit, duket e përshtatshme që të përcaktohet dënimi prej gjysmës së maksimumit të paraparë me ligj. I pandehuri dukshëm i ka paraqitur dhe \_\_\_\_\_ rrethana të rrejshme me qëllim që ti shtyj ata që ti japin atij të holla. Ai nuk ka kryer shkelje të përsëritura e as nuk i ka tejkaluar funksionet e tij e as nuk e ka refuzuar ekzekutimin e një detyre zyrtare, që konsiderohen si shkelje potencialisht më të rrezikshme të dispozitës së njëjtë.

Gjykatësi mendon që nuk ekzistojnë faktorë specifik që mund të llogariten si rrethana lehtësuese në favor të pandehurit. Faktet që ai nuk është dënuar më parë ose që është sjell mirë gjatë gjykimit ose që ai është kryefamiljar dhe që jeton në një familje të madhe, janë të gjitha të parëndësishme. Këto rrethana nuk e kanë parandaluar Abedin Muzlijajn nga kryerja e krimit për të cilin është gjetur përgjegjës dhe atyre nuk mund ti jepet ndonjë vlerë shtesë në përcaktimin e dënimit.

Në anën tjetër, ekziston një prej kushteve për shqiptimin e dënimit me kusht, sipas nenit 44.3 KPK, domethënë që ti jepet mundësia Abedin Muzlijajt që të ketë një start të ri në jetë, pasi që ka dështuar aq keq në ekzekutimin e detyrave të tij zyrtare.

Dënimi me kusht prej një viti dhe gjashtë muaj burgim shpallet me kusht që i pandehuri të kompensojë dëmet që ia ka shkaktuar palëve të dëmtuara, siç përcaktohen më poshtë, brenda 15 ditëve pasi që ky aktgjykim merr formë të prerë.

Mundësia që gjykatësi të imponojë një kusht të tillë parashihet në nenin 43 para 2 i KPK ku ceket që: “Në dënimin me kusht, gjykata mund të caktojë që dënimi të ekzekutohet nëse nëafatin e caktuar personi i dënuar nuk e kthen përfitimin pasuror të fituar me kryerjen e veprëspenale, nuk e kompenzon dëmin që e ka shkaktuar me vepër penale... “.

Përfundimisht, në bazë të nenit 391.1 n.5) dhe 278 KPPK, koha e kaluar në paraburgim dhe në arrest shtëpiak do të llogaritet si pjesë e dënimit.

### **Kërkesë Pasurore Juridike**

Është e pakontestueshme që ka pasur një kalim të parave në mes të \_\_\_\_\_ dhe një njërën anë dhe Abedin Muzlijajt në tjetrën. Shuma e të hollave (4.500,00 euro dhe 700 franga zvicerane) gjithashtu është e pakontestueshme.

Siç është gjetur në këtë vendim, nuk ka pasur arsye ligjore për kalimin e të hollave, i cili është arsyetuar ekskluzivisht me shpërdorimin e autorizimit zyrtar të kryer nga ana e të pandehurit.

Prandaj i pandehuri duhet ti ja kthej të hollat \_\_\_\_\_ dhe \_\_\_\_\_, të cilët e kanë kërkuar këtë gjatë gjyqimit, me kërkesë të Prokurorit dhe të gjykatësit.

Prandaj, në bazë të nenit 112.2 KPPK, Abedin Muzlijaj urdhërohet që ti paguaj dëmet që i janë shkaktuar \_\_\_\_\_ dhe \_\_\_\_\_, të përcaktuara në shumë prej 4.500,00 euro dhe 700 franga zvicerane.

### **Shpenzimet**

Pasi që i akuzuari Abedin Muzlijaj është shpallur fajtor, ai duhet të paguaj shpenzimet e procedurës penale me përjashtim të përktimit. Në bazë të nenit 100 KPPK, i akuzuari urdhërohet që të paguaj shpenzimet e procedurës, që janë përcaktuar në shumë prej 100,00.

Procesmbajtëse

\_\_\_\_\_  
Jacqueline Ryan



Gjykatësi Kryesues

\_\_\_\_\_  
Francesco Florit

### **KËSHILLË JURIDIKE:**

Në bazë të nenit 473.3 KPPK kundër këtij aktgjykimi mund të paraqitet ankesë brenda tetë ditëve nga pranimi i kopjes së aktgjykimit. Ankesa duhet ti drejtohet Gjykatës së Qarkut në Pejë.